

# Raporti Financiar dhe Makro Për Q3 2019

# WVP

## FUND MANAGEMENT TIRANA SH.A.

Raporti i 3 Mujorit të tretë 2019 për  
Investitorët dhe Publikun

## Tabela e Zhvillimeve

Hyrje .....	1
Perspektiva e Tregut.....	2
Analiza e Risqeve.....	3
Performanca, Statistika dhe Fakte .....	4
Disa Këshilla nga Ne për Ju.....	5

# HYRJJE

Të gjithë investitorëve,

Në mbyllje të 3 mujorit të tretë të vitit 2019, **WVP FUND MANAGEMENT TIRANA** po ju shkruajmë për t'ju raportuar mbi performancën dhe ecueshmerinë e fondit **WVP Top Invest**. Në tre muajt e kaluar tregjet kanë pësuar luhatshmëri relativisht mbi normalen për shkak të faktorëve makroekonomikë. Bazuar në raportin paraprak fondi priste që të arrinte një çmim për kuotë prej 1040 Lekësh. Ky objektiv u përmbush tek sa luhatjet e tregjeve botërore na lejuan të avancojmë më tej.

***Ky raport ju kushtohet kryesisht investitorëve tanë por jep informacion edhe për individët ose institucionet publike e private të interesuara në veprimtarinë tonë.***

Ngjarjet më e rëndësishme e këtij 3 mujori në tregjet financiare ishin tensionet USA-Kinë dhe lëvizjet e pritshme nga Bankat Qëndrore Europiane dhe Amerikane. Në muajt që kaluam pamë një qëndrim të Bankës Botërore Qëndrore ndaj luftës së tyre me inflacionin. Investitorët vazhdojnë të jenë të uritur për kthime të favorshme investimi duke kërkuar dhe stabilitet njëkohësisht. Normat e interesit vazhdojnë të bien duke bërë që investitorët të rrisin ekspozimin e tyre në aksione. Bota e investimeve pret ende të shohë rezultatet që do të japin politikatat lehtësuese të Bankave Qëndrore.

Raporti i mëposhtëm do të jetë i përmbledhur dhe solid në pikat më kryesore të vëmendjes tonë rreth strategjive të fondit dhe ekonomisë botërore, faktorë këta që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën tonë.

# Perspektiva e Tregut

Në këto momente që shkruajmë ambienti investues në të cilin ndodhemi vazhdon të qëndrojë në ujra të trazuara ashtu si në tre mujorin e fundit. Performanca e tregjeve botërore financiare ka qënë e mirë pavarësisht pasigurive që kanë pushtuar tregun këtë vit. Në letrën tonë vjetore shkruam se, prisnim katër risqe kryesore për të menaxhuar:

1. Yield Curve
2. Borxhi i Akumuluar i Korporatave
3. Normat e pritura të interesit bazë në Amerike dhe Europë
4. Ngadalësimi i ekonomisë botërore

Synimi i fondit vazhdon të mbetet i njëjtë me qëllim arritjen e:

1. Cilësisë të kompanive në portofolin e fondit;
2. Vlerës dhe diversifikacionin që u ofron investitorëve në Shqipëri;
3. Likuiditetit
4. Fitimeve solide në horizont afatgjatë.

Risqet e shkruara në fillim të vitit vazhdojnë të luajnë rrolin kryesor ashtu siç ne parashikuar, specifikisht normat e interesit dhe ngadalësimi i ekonomisë botërore. Tensionet tregëtare midis USA dhe Kinës vazhdojnë të jenë shumë definitive në performancën e fondit pasi ndikojnë tek e gjithë ekonomia botërore. Yield Curve nuk duket të jetë më një shqetësim primar për momentin. Mesa duket kemi hyrë në një epokë të re ku ky indikator nuk paraqet më saktësinë e dikurshme. Kriza botërore e para një dekade ka sjellë ndryshime rrënjësore në mënyrën se si risqet llogariten dhe perceptohen. Në raportin e fundit ju shkruajtëm se investitorët presin dhe po vënë nën presion Bankat Qëndrore që të lehtësojnë politikën monetare me qëllim stimulimin e ekonomisë.

Tashmë kjo gjë është realizuar pasi të dy Bankat Qëndrore më të rëndësishme në bote ECB (Europë) dhe FED (Amerikë) kanë ulur tashmë normat asthu siç kishim parashikuar. **Bota pret me ankth fillimin e një reçesioni në vitin pasardhës por sipas pritshmërive tona kjo nuk do të ndodhë deri në 2022.** Kyç për vazhdimësinë e këtij parashikimi do të jenë rezultatet financiare Q3 të korporatave.

# Analiza e Risqeve

## 1. Yield Curve

Yield Curve është rikthyer në formën e saj natyrale. Grafiku më poshtë tregon të dhënat për muajin Tetor pas përfundimit të 3 mujorit të tretë dhe është përzgjedhur specifikisht sepse tregon një situatë më realiste rreth asaj që mund të presim. Arsyeja kryesore përse kjo kurbë po i rikthehet deri diku normalitetit është për shkak të uljeve të normave të interesit. Investitorët kanë shpresa që ulja e tyre do ti japë, një hov të ri ekonomisë duke bërë që kërkesa për obligacione afatgjata të jetë më e ulët se në tre mujorin e kaluar.




Figura 1 Guru Focus

## 2. Borxhi i Akumuluar i Korporatave

Në këtë pikë nuk kemi asnjë zhvillim të ri dhe gjendja vazhdon të jetë e njëjtë po ashtu si gjatë raportit të kaluar. Siç shpjeguam në fillim të këtij raporti normat e obligacioneve 10 vjeçare janë shumë të ulta dhe kanë vazhduar të bien. Ky risk po manifestohet si fillim në borxhin e individëve ndaj kredive dhe leasing per makina dhe ekziston frika e krijimit të një flluske. Ngelet për tu parë dhe ne jemi duke e monitoruar me kujdes këtë risk. Për një përshkrim më në detaje të riskut te borxhit të korporatave ju lutem ti drejtoheni raportit tonë të mëparshëm për Q1 2019.

## 3. Normat e pritura të interesit bazë në Amerike dhe Europë

Federal Reserve (Banka Qëndrore Amerikane) ka qene në qëndër të vëmëndjes në të gjithë këta muaj pasi investitorët dhe tregjet kanë vënë në presion autoritetin qëndror financiar ne Amerikë për të ulur normat bazë të interesit në mënyrë që të stimulohet rritja ekonomike. FED dëgjoi investitorët dhe uli normat për herë të parë pas 11 vjetësh me një target prej 2.00% - 2.25%. Gjithashtu ECB (Banka Qëndrore Europiane) uli normën bazë të interesit në – 0.50% dhe lajmëroi fillimin e stimujve në ekonomi duke blerë tituj në vlerën e 20 Billion Eurove çdo muaj nga Tetori e derisa inflacioni në Eurozonë të jetë më i lartë dhe i qëndrueshëm.

## 4. Tensionet USA-Kinë dhe ngadalësimi i ekonomisë botërore

Risku më serioz dhe ai që vazhdon të qëndrojë si shkaktari i luhatjes së madhe dhe pasigurisë së tregjeve vazhdon të manifestohet tek tensionet midis Amerikës dhe Kinës. Në raportin paraardhës shkruam se pasiguria në këtë pikë është e lartë dhe karakteri i Donald Trump nuk na jep siguri në asnjë fjalë të tij për shkak se shumë herë më parë ka thënë se do të arrihet një marrëveshje vetëm për ta prishur gjithçka pak ditë më vonë. Nga ai moment deri sot kjo gjë ka ndodhur disa herë dhe tashmë çuditërisht duke si diçka normale në këtë ambient financiar ku po jetojmë. Në këto kushte ne e cilësojmë për momentin këtë risk si sistematik dhe të pa diversifikueshëm pasi faktet tregojnë se ka fuqinë të lëvizë të gjithë tregjet botërore po ashtu siç kishte dhe pak muaj më parë.

Përsa i përket ekonomisë botërore vihet re inflacioni i ulët në të gjitha ekonomitë kryesore dhe sipas sondazheve të ndryshme ka deri në 60% mundësi të kemi një recesion ne 2 vitet e ardhshme gati dyfishi i probabilitetit të cilin raportuam tre muaj më parë. E dimë që do të vijë por askush nuk mund ta parashikojë me saktësi se kur.

# Performanca, Statistika dhe Fakte

Nga fillimi i fondit deri në periudhën **30.09.2019** **WVP Top Invest** ka regjistruar një fitim **NETO** për investitorët në vlerën e **4,3%**. Fale diversifikimit dhe menaxhimit të risqeve fondi vazhdon të rritet në nivele të qëndrueshme. Fondi ka arritur një performancë të përafërt me Benchmark-un e tij, në periudha të ndryshme kohore. Benchmark llogaritet si një miks i tregjeve Europiane dhe Amerikane për shkak se këto janë kontinentet ku fondi ka prezencë në investime. Në rast se kthimi i fondit është më i lartë se i Benchmark-u kjo do të thotë që ne i kemi kaluar në performancë tregjet në tërësi në të cilat ne investojmë. Pra nëse ju do të investonit në fondin tonë **WVP Top Invest** dhe njëkohësisht do të blinit çdo kompani të mundshme të cilat ekzistojnë brenda universit në të cilin fondi selekton (mbi 600 aksione të kompanive) do të kishit fitim më të ulët në rastin e dytë. Kjo tregon që fondi ka përzgjedhur kompani të cilat kanë performuar më mirë se mesatarja e tregut në tërësi. Për të arritur një performancë reale mbi Benchmark-un fondit i duhet të ketë me shumë cash për të investuar.

## Performance

WVP Top Invest %	WVP Benchmark ** %	
1M	4.63%	3.66%
3M	1.96%	3.42%
6M	1.94%	5.25%
1 Year	1.17%	4.61%
YTD	16.18%	18.97%

Total Return since  
inception % 4.31%


Vlera NETO e asetëve dhe kuota e fondit për datën **30.09.2019** qëndrojnë në vlerën e **102,985,994.79 Lekë** dhe **1.043,0984 Lekë/Kuotë**. Fondi arriti një devijim standart prej **13.20%** dhe ju atashua nota e riskut **5 (Risk Mesatar)**. Për më në detaje bashkëngjitur të dhënat:

## Information about the Fund

Name of the Fund	WVP Top Invest
Inception Date	29.3.2018
Currency of the shares	LEK
Net value	102,985,944.79
Unit Price	1,043.0984
Fund Type	Accumulation
Custody Bank	First Investment Bank Albania
Subcustody Bank	First Investment Bank Bulgaria
	Clearstream
Benchmark	WVP Benchmark
Standard deviation	13.20%
Risk class	5


Historiku i çmimit të kuotës deri më **30.09.2019**:

### Unit price



Përsa i përket ekspozimit gjeografik investimet tona vazhdojnë të jenë më të përqëndruara në Amerikë, Gjermani dhe Francë dhe tashmë edhe Zvicër, me pjesën tjetër të alokuar në shtete të tjera të zhvilluara Europiane. Më poshtë gjeni të dhënat e detajuara mbi Ekspozimin Gjeografik të **WVP Top Invest**:

### Geographic Exposure




Këto pesha janë subjekt i ndryshimeve në bazë të politikave investuese referuar prospektit.




**WVP Top Invest** vazhdon të përqëndrojë pjesën më të madhe të investimeve në në Shërbimet Financiare, Industrinë e lëndëve të konsumit të përditshëm kjo e fundit për shkak të qëndrueshmërisë më të lartë që këto kompani kanë në bursa dhe Kompanitë Farmaceutike & Biotech. Kompanitë Farmaceutike & Biotech kanë luhatshmëri më të lartë por dhe fitime të pritura më të mëdha dhe ne i kemi kombinuar me industrinë mbrojtëse për të pasur një kosto/benefit të pëlqyeshëm dhe në mënyrë që të menaxhohen risqet por në të njëjtën kohë duke sjellë fitime më të larta se mesatarja në afatgjatë. Më poshtë gjeni të detajuar ekspozimin e WVP Top Invest në industrinë përkatëse:

### **Sectoral Exposure**




Përsa i përket riskut monetar më datë **30.09.2019**, **3.11%** e portofolit ndodhej në llogaritë tona në Lekë dhe gjithë asetet ishin në valutë. Këto vlera llogariten pas aseteve Cash të lëna mënjanë për detyrimet afatshkurtëra të fondit. Kjo do të thotë se fondi ka nevojë për kapital shtesë për të vazhduar të investojë në kompani të tjera apo për të rritur zotërimin në kompani ekzistuese.

### Exposure by Type of Instrument



### Currency Exposure



Gjatë këtij 3 mujori fondi nuk e ka parë të arsyeshme të shtojë kompani të reja në portofolin e tij.

## Portofoli i Kompanive të WVP Top Invest



**Fondi zotëron 36 kompani dhe nuk ka në planet e tij afatshkurtëra të shesë asnjë nga pozicionet e tij në kushte tregu normale. Më poshtë gjeni listën e detajuar të tyre.**

No.	Name Of The Company	ISIN	Currency	No. Of Shares	Price	Exchange Rate	Value in ALL	% NAV
1	Procter & Gamble Co/The	US7427181091	USD	330	124.3600	111.700000	4,584,033.96	4.45
2	Nestle	CH0038863350	CHF	328	108.2400	112.440000	3,991,925.84	3.88
3	Walmart Inc	US9311421039	USD	295	118.6800	111.700000	3,910,684.02	3.80
4	Apple Inc	US0378331005	USD	150	223.9700	111.700000	3,752,617.35	3.64
5	Diageo PLC	GB0002374006	GBP	800	33.3300	137.530000	3,667,099.92	3.56
6	Zurich Insurance Group AG	CH0011075394	CHF	80	382.0000	112.440000	3,436,166.40	3.34
7	SANOFI SA	FR000120578	EUR	320	85.0400	122.110000	3,322,955.01	3.23
8	Roche Holding AG	CH0012032048	CHF	100	290.4500	112.440000	3,265,819.80	3.17
9	BOEING	US0970231058	USD	75	380.3900	111.700000	3,186,717.23	3.09
10	Facebook Inc	US30303M1027	USD	160	178.0800	111.700000	3,182,645.76	3.09
11	Merck KGaA	DE0006599905	EUR	250	103.5000	122.110000	3,159,596.25	3.07
12	Unilever NV	NL0000388619	EUR	455	55.1500	122.110000	3,064,136.76	2.98
13	UNITED TECHNOLOGIES CORP	US9130171096	USD	200	136.5000	111.700000	3,049,410.00	2.96
14	British Petroleum PLC	GB0007980591	GBP	4,250	5.1560	137.530000	3,013,694.89	2.93
15	Allianz SE	DE0008404005	EUR	115	213.3500	122.110000	2,995,999.38	2.91
16	Pfizer Inc	US7170811035	USD	735	35.9200	111.700000	2,949,014.04	2.86
17	HeidelbergCement AG	DE0006047004	EUR	360	66.4600	122.110000	2,921,555.02	2.84
18	EXXON MOBIL CORP	US30231G1022	USD	350	70.6000	111.700000	2,760,107.00	2.68
19	AXA SA	FR0000120628	EUR	965	23.4200	122.110000	2,759,722.63	2.68
20	Royal Dutch Shell PLC	GB00B03MLX29	EUR	820	26.9000	122.110000	2,693,502.38	2.62
21	TOTAL SA	FR0000120271	EUR	455	47.8850	122.110000	2,660,492.99	2.58
22	Deutsche Post AG	DE0005552004	EUR	690	30.5750	122.110000	2,576,124.14	2.50
23	Volkswagen Ag	DE0007664039	EUR	135	156.1200	122.110000	2,573,614.78	2.50
24	Intercontinental Exchange Inc	US45866F1049	USD	235	92.2000	111.700000	2,420,203.90	2.35
25	Siemens AG	DE0007236101	EUR	200	98.3500	122.110000	2,401,903.70	2.33
26	Goldman Sachs Group Inc	US38141G1040	USD	102	207.1900	111.700000	2,360,598.55	2.29
27	Henkel AG & Co KGaA	DE0006048432	EUR	190	90.8000	122.110000	2,106,641.72	2.05
28	Lloyds Banking Group PLC	GB0008706128	GBP	27,850	0.5412	137.530000	2,072,909.92	2.01
29	Berkshire Hathaway Inc	US0846707026	USD	88	207.9800	111.700000	2,044,360.21	1.99
30	BASF SE	DE000BASF111	EUR	260	64.1400	122.110000	2,036,355.20	1.98
31	BNP Paribas SA	FR0000131104	EUR	345	44.6700	122.110000	1,881,855.53	1.83
32	Telefonica SA	ES0178430E18	EUR	2,200	7.0010	122.110000	1,880,762.64	1.83
33	Bayerische Motoren Werke AG	DE0005190003	EUR	235	64.5700	122.110000	1,852,891.03	1.80
34	ING Groep NV	NL0011821202	EUR	1,530	9.6040	122.110000	1,794,298.99	1.74
35	Fresenius SE & Co KGaA	DE0005785604	EUR	340	42.8900	122.110000	1,780,681.29	1.73
36	Daimler AG	DE0007100000	EUR	300	45.6050	122.110000	1,670,647.97	1.62

# Disa këshilla nga Ne për Ju...

Ashtu si në raportet tona të mëparshme po e përmbyllim këtë raport duke ju siguruar edhe njëherë se:

Në të gjithë historinë e tregjeve financiare 3 gjëra janë gjithmonë të sigurta;

1. Tregjet do të kenë **GJITHMONË** luhatshmëri;
2. Në afatgjatë tregjet **GJITHMONË** rriten sepse ekonomia botërore është vazhdimisht në rritje;
3. Gjatë periudhave të vështira frika është **GJITHMONË** ngjitetëse;

Siç tashmë dhe faktet tregojnë luhatshmëria është e dukshme. Nga një performancë ulët në fund të 2018 investitorët panë fitime prej **11.94%** në vetëm 3 muajt e parë të 2019 e më pas për ti rihumbur këto fitime dhe për ti rifituar edhe një herë pas rënies. Sigurisht në afatgjatë fondi pret vetëm rritje por duke pasur luhatshmëri her pas here të cilat janë normale siç mund të vërehet. Nga fillimi i tij deri në sot fondi regjistron një **FITIM NETO 4.31%** pas të gjitha kostove.

## Investitorët KUJDES!

Ky seksion përfundimtar ju dedikohet specifikisht investitorëve tonë ne WVP Top Invest. Gjatë periudhës **Tetor 2018-Shtator 2019** siç e shikoni shumë ndryshime kanë ndodhur. Ne duam t'ju kushtojmë pak nga koha jonë për t'ju dhënë këshillën më të vlefshme:

**“ Gjithmonë investoni periodikisht dhe rregullisht. Nuk ka rëndësi nëse keni investime të medha apo të vogla. Ju duhet të investoni optimalisht çdo muaj për të përfituar blerjen e kuotave me çmim mesatar. Ne nuk këshillojmë të investoni të gjitha parate tuaja menjëherë. Investitorët të cilët nuk investuan nga Dhjetori 2018-Shtator 2019 humbën rreth 20% rritje të kapitalit të tyre. Gjithashtu ata që pësuan rënie të investimit në fund të 2018 jo vetëm i rikuperuan humbjet por arritën të blejnë kuota me çmime SHUMË të lira krahasuar me sot. Për më tepër gjatë periudhës Mars-Shtator luhatjet ishin të mëdha dhe një investim i rregullt u siguroi investitorëve të përfitonin kuotat me çmime të ndryshme duke siguruar nje kosto mesatare ne afatgjatë. Mos u përpiqni të parashikoni uljet dhe ngritjet e tregut sepse është e pamundur. Askush nuk mund të gjejë kohën perfekte për të investuar. Na besoni në këtë rrugëtim dhe na lejoni t'ju shërbejmë sa më mire”**

**Ju Faleminderit!**